



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 433/2 prot.

Tiranë, më 19.5.2026

V E N D I M

Nr. 18, datë 19.5.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS SË RENDITJES SË KANDIDATËVE TË PROFILIT GJYQJAR,
PROKUROR DHE AVOKAT I SHTETIT, ME REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË
PROVIMIT TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Në mbështetje të neneve 248, 266 dhe 274 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenit 31 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 26 dhe aneksit 5 të Rregullores së Brendshme, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 19.5.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e renditjes së kandidatëve të profilit gjyqtar, prokuror dhe avokat i shtetit, me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Vlerësimit të Testit profesional dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik të provimit të pranimit për vitin akademik 2026-2027, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.